

#### IV. Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit (1689) –

##### 1. Fjalë hyrëse

Në kulturën e shkrimit shqip të arealit të Veriut feks një tekst në dorëshkrim, i njohur ndërkohë si *Letra e Pleqve të Gashit*, e cila datohet më dt. 30 maj 1689 e që duhet të jetë – në mos i kompiluar – të paktën i regjistruar si i tillë fjalë për fjalë në letër të bardhë prej (it.) <Giorgio Tol(l)ich>, atëbotë vikar i Dioqezës së Pultit. Meqë letra i drejtohet Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s në Romë, Toliq e shoqëron atë edhe me përkthimin përkatës italisht. Asgjëmangut, një dërgesë e tillë në dy variante kishte në zanafillë një synim të dyfishtë: së pari të mos hidhte hije dyshimi në autenticitetin e variantit origjinal, të kumtuar e firmosur nga *Krenat e Gashit*; e së dyti të ndërmjetësojë përmbajtjen e saj në instancat përkatëse pranë atij institucioni.

Në rast se lejohemi të përmbledhim tash po shkurt historikun e zbulimit dhe të përpunimit historik-filologjik të tekstit shqip, nuk mund të mos përmendim faktin, që kjo letër është zbuluar ngamot, dikur aty në fillimet e viteve '60 të shekullit të kaluar, kur Historiani i Shqipërisë Peter Bartl kryente hulumtime ballore në Arkivin Historik të Propaganda Fide-s në Romë lidhur me historinë ekleziastike të Kishës Katolike-Romake në hapësirën shqipfolëse. Sigurisht që letra iu bë gjithashtu e njohur mjedisit albanologjik ndërkombëtar po atë dhjetëvjeçar (1967), bash në revistën "Zeitschrift für Balkanologie" në një punim me bashkautor albanologun Martin Camaj.<sup>1</sup> Që kumti mbi ekzistencën e saj depërtoi edhe në truall shqiptar, por thjesht dhe vetëm si kumt me karakter njohës-enciklopedik, përkatësisht vetëm me një shënim me vendin ku mund të lexohej diçka mbi të – çka vjen me thënë pa emrin e zbuluesit dhe të bashkëpunëtorit të tij<sup>2</sup> –, këtë rrethanë nuk kemi përse e krehim dhe e tjerim sot në periudhën e tranzicionit (edhe) kulturor-intelektual shqiptar, meqë shumëkush është tashmë i ndërgjegjësuar, se kjo rrethanë kishte të bënte atëbotë me dhunën strukturore që ushtronte në vend aparati politik-ideologjik kryesisht ndaj shkencave albanologjike, duke futur në indeks shumë e shumë emra të padëshiruar të tipit të Martin Camajt, të cilët zhvillonin

<sup>1</sup> Bartl, Peter & Camaj, Martin: Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689 ZfB 5 [1967] 22-33.

<sup>2</sup> Khs. Shuteriqi 1978 84: „Letra është botuar në Zeitschrift für Balkanologie, Wiesbaden 1967, 23-33, me faksimile.“ Citimi në këtë mënyrë – pa emrat e autorëve, meqë Camaj ishte *persona non grata* në Shqipëri – paraqitet atëbotë si i vetmi opsion që mundësonte elitën shkencore-intelektuale të albanologjisë shqiptare t'u përmbahej gjithëherë parimeve etike të aktivitetit shkencor-intelektual bashkëkohor.

aktivitetin e tyre intelektual si pjesë e mërgatës politike-kulturore shqiptare në Perëndim. Andaj le të kalojmë menjëherë drejt e në temë:

\*  
\*   \*  
\*

Nxitjen për këtë shkrim të shkurtër na e mundësoi puna redaksionale a paradokohshme me një botim të tipit *Scripta minora*, ku përfshihen 35 + 1 studime të cemta që kanë për autor Peter Bartl-in (2016). Ndër këto shkrime është përzgjedhur edhe punimi në fjalë. Pa dashur assesi të hapim tash një parantezë, duke ndryshuar kështu regjistër e shestuar me këtë rast një laudatio fanmirë ndaj autorit dhe prurjeve të tij të vyera në shkencat historike albanologjike, lejohemi të citojmë vetëm njërën ndër ato pak ndërhyrje redaksionale të vetë autorit, pasi ka rilexuar me lupën e historianit produktet e mëhershme të punës së vet. I tillë është edhe një shënim redaksional në fusnotën nr. 14 të punimit të sipërpërmendur, të cilin po ia përcjellim lexuesit të plotë si fusnotë:

[*Fusnota në botimin origjinal:*] “Mbi Giorgio Tolich nuk kam mundur të mësoj dot gjë; disa forma gjuhësore [të emrit] e bëjnë të mundshëm [mendimin], që ai të mos ketë qenë shqiptar; megjithatë emri Toli, Toliq gjendet edhe në Shqipëri.”

[*Shtesa e fusnotës në ribotimin e dytë:*] “Përkundër mendimit të shprehur më 1967, <Tolich> ishte shqiptar. Ai ishte nga Gjakova në Dioqezën e Shkupit, kishte studiuar në Loreto teologji dhe filozofi ishte aktiv si misionar për disa vjet në Has. Ai zotëronte në mënyrë të përsosur përpos shqipes si gjuhë native edhe ,ilirishten’ (d.m.th. serbishten/kroatishten) dhe gjuhën turke. Tolich ishte njëri ndër tre kandidatët, që arqipeshkvi [i Tivarit] Andrea Zmaievich më 1683 i propozoi Propaganda Fide-s për [të marrë] vendin e ipeshkvit të Pultit. (APF, SOCG 487, fol. 412-412.) – P.B.”<sup>3</sup>

Ky vëzhgim redaksional mund të klasifikohet sot prej shumëkujt thjesht dhe vetëm – pra gjithherë me respektin e duhur (!) – si shembull

<sup>3</sup> Teksti në origjinal: „Über Giorgio Tolich habe ich nichts in Erfahrung bringen können; manche sprachlichen Formen machen es wahrscheinlich, daß er kein Albaner war, der Name Toli, Toliq ist allerdings auch in Albanien zu finden.

[Ergänzung für den vorliegenden Nachdruck: Im Gegensatz zur 1967 geäußerten Meinung war Tolich Albaner. Er stammte aus Gjakova in der Diözese Skopje, hatte in Loreto Theologie und Philosophie studiert und war einige Jahre als Missionar in Hasi tätig gewesen. Er beherrschte neben seiner albanischen Muttersprache perfekt die „ilirische“ (d.h. serbische) und die türkische Sprache. Tolich war einer der drei Kandidaten, die Erzbischof Andrea Zmaievich 1683 der Propaganda Fide für das Amt des Bischofs von Pulati vorschlug (APF, SOCG 487, f. 412-412.) – Bartl 2016 203].“ (Fsn. nr. 14)

i korrektesës profesionale që karakterizon a duhet të karakterizojë shpirtin intelektual të hulumtuesit në përgjithësi, meqë në pamje 'të parë' ky verifikim duket sikur nuk ndikon aspak si i tillë në vërtetësinë e dëshmisë gjuhësore me kumtin përkatës, përkatësisht interpretimin e saj në kuadrin historik-kulturor bashkëkohor. Prashtu, pa i anashkaluar assesi kësaj pamjeje, shkruesi i këtyre radhëve mëton në këtë shkrim t'i bëjë më fort hyzmet një pamjeje 'të dytë' ase të 'të tretë', që përcjell natyrshëm si reaksion zinxhir vetë ky verifikim:

- a) qoftë në plotësimin e portretit të shkruesit/kompiluesit të tekstit shqip të letrës, duke e ngërthyer atë – e pse jo! – si pjesëtar të asaj aradhe klerikësh që përkujdesën lëvrimin e shqipes në Arealin Kulturor të Veriut katolik shqiptar.
- b) qoftë në (ri)interpretimin filologjik të tekstit shqip, i cili u zhvillua atëbotë i tëri nën premisën se regjistruesi i tekstit nuk ishte, ase nuk duhej të ishte shqipfolës.

Trajtimin në vazhdim të këtyre dy çështjeve e shoqëron thukët riprodhimi diplomatik dhe tejskrimi i tekstit, duke përfunduar përmbylltas me ndonjë konsideratë e përgjithshme lidhur me vendin e këtij teksti në kulturën e shkrimit shqip në kapërcyell të shek. XVII.

## 2. Kush ishte <Giorgio Tol(l)ich>?

Verifikimi që i bën Bartl-i kumtit të vet të dikurshëm (sh. më lart) lejon shumëkënd – pa hyrë assesi në mëkat (!) – ta shqipërojë emrin e hedhësit në letër të bardhë të tekstit shqip si /Gjergj Toliq/ ase /Toli/ (?), i cili sipas Camajt dëshmohej si emër familjeje, sikurse edhe si emër personi në Shqipërinë e Veriut. Sa i përket përkatësisë së tij etnike-gjuhësore, pas gjase shqiptare, Bartl-i përcjell tashmë në debat si argument pozitiv kumtin e arqipeshkvit të Tivarit Andrea Zmajević dora vetë, i cili më 1683 i propozon Kongregacionit të Shenjtë edhe emrin Gjergjit tonë për të marrë postin e ipeshkvit, të mbetur atëbotë vakant në Dioqezën (tërisht shqipfolëse) të Pultit. Në këtë kumt, të cilin pati mirësinë të na e vinte në dispozicion Peter Bartl dora vetë, ndër të tjera mëtohet shprehimisht, se:

“Gjergj Toliq [...] ka lindur në Gjakovë të Dioqezës së Prizrenit, e cila është tashmë nën administrimin e imz. arqipeshkvit të Shkupit. Studioi filozofi dhe teologji në Kolegjin Ilirik të Loretos. Qe për disa vjet [me mision] në Has, vend pranë Dioqezës së Pultit. Zotëron gjuhën shqipe, [gjuha] e tij native, si edhe ilirishten [= serbishten] dhe turqishten në mënyrë perfekte. Është prift me sjellje të mbara, me nam të mirë,

fizionomi dhe karizëm. Ndërkohë është vikar i përgjithshëm i imz. arqipeshkëvit të Shkupit, si edhe famullitar i tregtarëve të Raguzës në Novipazar. [Është] në moshën aty te 47 vjeç.”<sup>4</sup>

Sigurisht që ky kumt vërtet nuk vulos e firmos katërcipërisht përkatësinë etnike-gjuhësore të personit në fjalë, por mund të klasifikohet bindshëm si një argument pozitiv që e tumir këtë përsiatje. Ndonjë të dhënë biografike shtesë lidhur me formimin meshtarak dhe natyrën e të riut Gjergj Toliq ka mundur të qëmtojë edhe shkruesi i këtyre radhëve sidomos gjatë kërkimeve të tija në Arkivin Historik të Shtëpisë së Shenjtë në Loreto (ASCL – mars 2015), ku Gjergji ynë rezulton të jetë regjistruar me formën e latinizuar të emrit: (= lat. <Georgius Tullich>). Në regjistrin e emrave të rishtarëve që kanë studiuar në atë kolegji gjatë viteve 1624-1686/91, mësojmë ndër të tjera, sa vijon:

“Më 4 janar 1659 u dërgua në kolegji prej zëvendësguvernatorit Imz. Ottoni-t për të gëzuar vendin e caktuar për njërën prej kishave të Tej-Drinit Giorgio Tullich prej [Dioqezës së] Prizrenit në [Mbretërinë e] Serbisë, i përzgjedhur prej Imzot Pjetër Bogdanit, ipeshkëv i Shkodrës. Është në moshën rreth 20 vjeç. Nuk e ka [marrë] Sakramentin e Altarit, as betim tjetër, përpos tonsurës [= marrjes së flokëve] të parë. Ka marrë disi njohuri në gramatikë [latine] dhe njeh katër gjuhë. Betimi i tonsurës së parë, që shërben edhe për dorëzaninë ipeshkvore [= it. dimissoria] ndodhet në arkivin [e kolegjit]. E shoqëroi në [Kolegjin e] Loretos Imz. Stanislao, ipeshkëv i Nicopoli-t dhe e priti Imz. Ottone, i cili edhe e dorëzoi [në kolegji]. Ky vend [në kolegji] mbeti bosh me largimin e Marin Vlladanjit të sëmurë e të paaftë për ta gëzuar. Më dt. 4 korrik [sic.<sup>5</sup>] të vitit 1659 bëri betimin. Më dt. 23 qershor 1664 u nis për në Prizren, në dheun e vet në Serbi, i thirrur prej ipeshkëvit Andrea Bogdani. Mori katër [urdhurat fetarë] të vegjël. Ka

<sup>4</sup> Pasazhi i plotë në origjinal: “[§ 2] D. Giorgio Tollich, quale (se ben tardi ritrovai) stimavo anco buono, e per il migliore tra, nazionali d’esser fatto Vesc.o di Sappa; e le sue qualità nelle riverenti mie delli 15.9.bre 1681 rappresentai quella Sac. Cong.ne. Egli è nato à Jakova nella Diocese di Prisen, che hora tiene in administrat.ne Mons.r Arcivesc.o di Scopia. Studii Filosofia, e Teol.a nel Coli.o Illirico di Loreto. Fù alquanti anni Miss.rio in Hassi luoco vicino alla Diocese di Pulati. Posiede la lingua Albanese sua nativa, come anco l’Illirica e Turchesca perfettam.te. È sacerdote di buoni costumi, buona fama, complessione, e presenza. Al presente è Vic.rio generale del pred.o Mons.r Arc.o di Scopia, e paroco de Mercanti Ragusei à Novopasaro. In età di quaranta sette anni in circa.” (APF, SOCG 487, fol. 412r)

<sup>5</sup> Nga krehja e materialit të librit të betimeve (mars 2015), të depozituar në Arkivin Roman të Kompanisë së Jesus-it (: ARSI Rom 229 9v) është regjistruar dt. 2 korrik 1659 si datë e betimit të personit në fjalë, khs. <Georgius Tullich 2 Julii 1659> (fol. 9v).

studiuar gramatikë, dy vjet të papërfunduar në filozofi dhe gjysmën e 'Casi [di Coscienza]'. Ishte inteligjent, por i prirur gjithmonë së prapthi. Ishte me mendime keqdashëse dhe tinëzar si njeri."<sup>6</sup>

Kjo dëshmi e re, që po e përcjellim tash në debat, plotëson me të dhëna të reja si biografinë, ashtu edhe ndonjë tipar negativ të natyrës dhe temperamentit paksa të lëkundur të gjakovarit Gjergj Toliq. Shpresojmë kështu të kemi saktësuar deri diku edhe ndonjë informacion mëdyshës, edhe pse të patëkeq që e mësojmë prej Imz. Andrea Zmaievich-it në ndërhyrjen e tij, sa i përket formimit të Gjergjit tonë në Loreto. Vlen të përmendim këtu, ndër të tjera, që ai nuk arriti t'i përfundojë studimet e rregullta në këtë kolegji e se përgjatë katër viteve të qëndrimit aty ai iu përkushtua përpos gramatikës latine, kryesisht filozofisë dhe formimit të përgjithshëm (: 'Casi di coscienza'), pra aspak programit të mirëfilltë teologjik, i cili zhvillohej zakonisht dy vitet përmbyllëse të qëndrimit tetë- deri dhjetëvjeçar në kolegji për çdo nxënës.

Më shumë se kaq nuk kemi mundur të mësojmë gjë gjatë qëmtimit të sipërfaqshëm të materialit arkivor në Romë e Loreto, ndërkohë që vështirë se do të arrijmë të mësojmë dikur diçka më shumë prej veprave themelore enciklopedike të historisë së Kishës Katolike-Romake, përderisa Gjergji ynë pas gjithë gjasash nuk arriti të ngjiste gjatë gjithë karrierës së tij klerikale ndonjë katedër ipeshkvore ose arqipeshkvore.

### **3. Letra e Pleqve të Gashit në këndvështrimin filologjik**

Hyjmë kështu në atë temë që trajtoi aq bukur e mirë dikur Martin Camaj në punimin e cituar më lart (Bartl & Camaj 1967), ku ndërmoi njëkohësisht edhe riprodhimin diplomatik dhe tejskrimin e tekstit në kodin aktual alfabetik të gjuhës shqipe. Pa dashur të hyjmë këtu aspak në detaje që kanë të bëjnë me realizimin grafik të njërive të

<sup>6</sup> Teksti original: "4 Gennaro 1659 fù mandato in Coll.º da Mons. Vice-Governatore Ottoni per goder il loco dovuto ad una delle Chiese del Drino citrà GIORGIO T U L L I C H da Prisren in Servia eletto da Mons. Pietro Bogdani Vescovo \ di Scuttari. È d'anni 20 incirca. Non ha Viatico ne altra fede, se non quella della prima Tonsura. È alquanto introdotto nella grammatica, e intende quatro lingue. La fede della prima Tonsura che serve anche per Dimissoria stà nell'Archivio. Mons. Filippo Stanislao Vesc.º di Nicopoli il condusse a Loreto, e Mons. Ottone l'accettò et egli mel consegnò. Questo loco vacò per la partenza di Marino Vladagni incapace per malattia di goderlo. Adi 4 di Luglio fece il giuramento dell'anno 1659. Adi 23 Giugno 1664 parti per Prisren sua Patria in Servia chiamato dal Vesc.º Andrea Bogdani. Presi li quatro minori. Ha studiato grammatica, due anni non finiti di filosofia e un e mezzo di Casi: havea ingegno ma sempre applicato in male. Fù di pensieri torbidi sollevatissimo e scaltro quanto mai persona." (Cattalogo delle persone che hoggi si truano in Collegio Illyrico, në: ASSC tit 30-32, fol. 33r)

veçanta, përkatësisht të pasqyrimin grafik të njërit apo tjetrit tingull me funksion kuptim dallues në variantin dialektor gegnisht, që përcjell sipas rastit Toliq në funksionin e hartuesit, ase thjesht të regjistruarit apo kompiluesit të kumtit gojor të *Krenave të Gashit*, analiza filologjike e tekstit na qartëson që Toliq ndjek në këtë letër kulturën tashmë të stabilizuar të shkrimit shqip në arealin e Veriut, përkatësisht në atë zonë (të Pultit), ku siç kemi vërejtur dikur (Bartl & Demiraj 2008 55v.) duhet të kishte zënë rrënjë e hedhur shtat tradita e mirë me atë variant të kodit alfabetik shqip që zhvilloi Pjetër Budi. Bëjmë fjalë këtu për një traditë që e ndeshim thujse njëllor edhe shtatë dekada më vonë (13 shkurt 1761) në një letër italisht-shqip, me të cilën etërit françeskanë të Pultit i drejtohen po zyrtarisht administratës turke në Pejë. Pas një ballafaqimi të kodit alfabetik, të përdorur në të dyja këto letra, shkruasi i këtyre radhëve arriti në një përfundim paraparak, të dhënë në mënyrë tabelare, sa vijon:

Alfabeti i Manastirit	API	Grafia e letrës së Pleqve të Gashit 1689	Grafia e letrës së fretërve të Pultit 1761
a	[a] ~ [a:]	a ~ aa	a ~ aa
b	[b]	b	b
c (~ x)	[ts/dz]	(z)	z
d	[d]	d	d
dh	[ð]	ξ	ξ
e	[e] ~ [e:]	e ~ ee	e ~ ee
ë	[æ/ɜ/ə]	(e, a)	(e)
f	[f]	f	f
g	[g]	g-A	g-A, gh-E
gj (~ xh)	[j] (~ [dʒ])	g-E	g-i, gi-A/e
h	[h]	h	h
i	[i] ~ [i:]	i ~ ii/ij	i ~ ii/ij
j	[j]	i	i, j
k	[k]	k, c-A	k, -kch-, c-A, ch-E
l	[l]	l, gl	l
ll	[ʎ]	l	(?)
m	[m]	m	m
n	[n]	n	n
nj	[ɲ]	gn	gn
o	[o] ~ [o:]	o (~ ?)	o (~ ?)
p	[p]	p	p
q (~ ç)	[c] (~ [tʃ])	ch-i	c-E, -cc#
r	[r]	r	r
rr	([rr])	(?)	(?)

s	[s]	s, í, -ss-/-ís-	s/í, -ís-
sh	[ʃ]	sc/íc-E/C, íci-A, s-	sc/íc-E, íci-A, s-
t	[t]	t, tt	t, tt
th	[θ]	ξξ	ξξ
u	[u] ~ [u:]	u, v ~ uu	u, v ~ uu
v	[v]	v, u	v, u
y	[y] ~ [y:]	ɸ, u? ~ ɸɸ	ɸ ~ ɸɸ
z	[z]	ε	ε

Ndërsa hetimi në thellësi i gjurmëve të kodit alfabetik në tekstin tonë na lejon të mëtojmë tash pa hezitim se kemi të bëjmë me një vazhdimësi të drejtpërdrejtë të traditës më të hershme shkrimore që krijoi dhe përhapi në arealin kulturor të Shqipërisë së Veriut (pra edhe në Pult) penda e Pjetër Budit, problem paraqet ende ndonjë zgjidhje grafike, e cila lë vend ende për diskutim. Bëjmë fjalë këtu kryesisht për realizimin grafik të së ashtuquajturës <e-ja e pazâne>, përkatësisht të zanores qendrore <ë> = [ə], e fiksuar sot si e tillë në sistemin e zanoreve të shqipes letrare standarde, por që në të folmet bashkëkohore gegnisht edhe në ato zona ku shfaqet ende, del vetëm në rrokje të patheksuar. Paraqitja grafike e këtij tingulli herë me <a>, khs.: <me darguom>, <kata>, <katar>, <pressâ> (= <pressam>), <kalaεuom>, <lisciognâ> (= <lisciognam>), <uignan>, <uorfania> etj.; dhe herë me <e>, khs. <gere>, <rijne>, <Patrene Sebastiane>, <tietarane>, <scinte> etj.; është për Camajn një tregues i qartë i vështirësisë që ka pasur Toliqit (si *jo-native speaker* i shqipes) për ta rrokur këtë tingull zanor në ndërgegjen e vet gjuhësore, andaj edhe shmangie të kësaj natyre janë për të më se të kuptueshme e të shpjegueshme.<sup>7</sup>

Të dhënat e reja biografike që kemi fituar ndërkohë për përkatësinë etnike-gjuhësore të Gjergjit tonë e vendosin këtë problem të karakterit sa filologjik aq edhe gjuhësor në një tjetër rrafsh diskutimi. E këtë rrafsh nuk e relativizon aspak edhe ndonjë dokument që mund të zbulohet dikur e të verë në pikëpyetje përkatësinë e tij etnike, pas gjase shqipfolëse. Për këtë na mjafton t'i referohemi faktit të përcjellë në regjistrin e Kolegjit të Loretos (shih më lart), që rishtari i ri Gjergj Toliq ishte njohës i katër gjuhëve të ndryshme.

Nga një vëzhgim paraprak i zgjidhjeve grafike në tekst, ku pritet të na shfaqet ky tingull zanor (sigurisht në rrokje të patheksuar), vëmë oroe se pasqyrimi i tij grafik me <a> shfaqet kryesisht në pozicion

<sup>7</sup> Camaj (*art. cit.*) sjell në këtë rast si raste paralele, përpos shqiptimit të shmangur të këtij tingulli prej fretërve françeskanë italianë në Veri të Shqipërisë, ashtu edhe ndonjë shmangie përkatëse në sistemin zanor në të folme të ndryshme arbëreshe në Italinë e Jugut, duke i parë këto pikërisht si ndikime të mjedisit rrethues italishtfolës.

mesor, përkatësisht në brendësi të strukturës fonologjike të fjalës, ndërkohë që zgjidhjet grafike me <e> na shfaqen kryesisht në pozicion fundor dhe ose përpara bashkëtingëllores hundore /n/. Ky opsion i fundit na shfaqet gjithashtu rregullisht në pozicion nistor përpara njësive leksikore që nisin me /nC<sup>o</sup>/, khs. <me endegnun>, <ende> (~shq. vj. <nde> = [ndə]); çka na kujton as më shumë e as më pak, por bash ato zgjidhje të vështira grafike që përcolli Buzuku në “Mesharin” e tij (në fjalët që nisin me /n-/).<sup>8</sup>

Një hulumtim i thelluar i këtij problemi ku ndërlikohen me njëra-tjetrën fusha e filologjisë me gjuhësinë historike dhe tipologjinë gjuhësore areale do t’i jepte tjetër drejtim këtij studimi, i konceptuar mirëfilli si informacion shtesë për një përmendore modeste të kulturës së shkrimit shqip, përkatësisht mbi kompiluesin ose hartuesin e saj në fund të shek. XVII. Andaj, le të mjaftohemi qoftë edhe përkohësisht me zgjidhjen paraprake, se “shmangie” të kësaj natyre kanë të bëjnë si me ndërgjegjen gjuhësore të shqipfolësit Gjergj Toliq, ashtu edhe me variabilitetin e theksuar të shqiptimit të këtij tingulli zanor të patheksuar në ato të folme që përfaqësonin në një mënyrë a një tjetër *Krenat e Gashit*.

#### **4. Riprodhimi diplomatik dhe tejkshkrimi i tekstit shqip**

Këtë zgjidhje kemi mbajtur parasysh edhe më poshtë në riprodhimin diplomatik dhe tejkshkrimin e tekstit, i cili dallon vetëm në pak raste prej zgjidhjeve që propozon Martin Camaj në punimin e cituar më lart.

---

<sup>8</sup> Shih më hollësisht Çabej 1968 (I) 75.